



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

---

Prishtinë, më 25 janar 2013  
Nr. ref.:RK374/13

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI115/12**

Parashtrues

**Fadil Salihu**

**Vlerësimi i rregullsisë së zgjedhjes së Kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje në  
Ferizaj, më 4 nëntor 2012**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Fadil Salihu nga Ferizaj (në tekstin e mëtejshëm: Parashtruesi).

## **Vendim i kontestuar**

2. Parashtruesi konteston vendimin për zgjedhjen e Kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje në Ferizaj, më 4 nëntor 2012.

## **Objekti i çështjes**

3. Interpretimi i Statutit të Lëvizjes Vetëvendosje përkitazi me zgjedhjen e kryetarit të kësaj lëvizjeje në Ferizaj.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 dhe në nenin 21.4 të Kushtetutës; në nenin 20, në nenin 22.7 dhe në nenin 22.8 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe në rregullin 56, paragrafi 2, të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Parashtruesi i kërkesës parashtrorë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), më 3 dhjetor 2012.
6. Me Vendimin e Kryetarit (Nr. GJR. 115/12, e 6 dhjetorit 2012), gjyqtarja Arta Rama-Hajrizi është emëruar Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit (Nr. KSH. KI115/12), është caktuar Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Prof. Dr. Enver Hasani.
7. Më 25 janar 2013, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarës Arta Rama-Hajrizi, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Prof. dr. Enver Hasani, i paraqiti Gjykatës, në përbërje të plotë, rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

8. Më 4 nëntor 2012, janë mbajtur zgjedhjet për kryetar të Lëvizjes Vetëvendosje, në Qendrën e kësaj lëvizjeje në Ferizaj.
9. Në të njëjtën ditë, kryetar i Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje në Ferizaj, me shumicë votash, u zgjodh personi që edhe më herët kishte kryer funksionin e kryetarit të Qendrës.

## **Prezimet e parashtruesit**

10. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, në zgjedhjet për kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje në Ferizaj, të mbajtura më 4 nëntor 2012, është zgjedhur personi që nuk i plotëson kriteret në bazë të Statutit të Lëvizjes Vetëvendosje, të muajit korrik 2012.
11. Parashtruesi, në veçanti, citon nenin 17 të Statutit të Lëvizjes Vetëvendosje, i cili thotë:

*“Anëtar i Lëvizjes Vetëvendosje, nuk mund të jetë individi që ka marrë pjesë në akte komprometuese, që i cenojnë parimet dhe dokumentet themeltare të Lëvizjes Vetëvendosje. Si akte komprometuese njihen veprat në vijim:*

*a) Bashkëpunimi me shërbime inteligjente/informative të huaja, si dhe me forca ushtarake, paramilitare dhe policore të huaja, që kanë ushtruar ose që vazhdojnë të ushtrojnë dhunë fizike dhe psikologjike ndaj qytetarëve”.*

12. Bazën për pretendimin e tij, parashtruesi e gjen në faktin se personi i përmendur ka qenë i zgjedhur në postin e kryetarit, të cilin e kishte kryer në periudhën paraprake, dhe se, gjatë mandatit të tij paraprak, kanë ndodhur keqpërdorime financiare, të cilat janë evidentuar nga Auditori i Lëvizjes.
13. Parashtruesi pretendon se personi i përmendur (kandidati për kryetar të Lëvizjes Vetëvendosje në Ferizaj,) në momentin e zgjedhjeve, nuk ishte i pranishëm në Kosovë dhe nuk kishte marrë pjesë në fushatë, si dhe është zgjedhur në postin e kryetarit duke blerë vota.
14. Parashtruesi thekson në kërkesë *“se i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për shkak se dëshiron të çojë luftë kundër totalitarizmit në praktikë, kundër blerjes së postit, abuzimeve dhe që drejtësia të fitojë”*.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

15. Në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të vendosë për kërkesën e parashtruesit, së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet procedurale për pranueshmëri, të parapara me Kushtetutë. Përkritazi me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

16. Parashtruesi i kërkesës nuk specifikon se cila e drejtë kushtetuese apo ligjore i është cenuar me zgjedhjen e personit të përmendur kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje në Ferizaj, edhe pse neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese thotë:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.*

17. Sa i përket kërkesës specifike të parashtruesit të kërkesës, Gjykata i referohet rregullit 36, paragrafi 3, pika f, të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, i cili parasheh:

*“Gjykata një kërkesë e konsideron si të papranueshme kur: f) kërkesa nuk është racione materiae në pajtim me Kushtetutën”.*

18. Gjykata ka për detyrë të shqyrtojë nëse ka kompetencë *ratione materiae* në çdo fazë të procedimit. Pajtueshmëria *ratione materiae* e ndonjë kërkesë me Kushtetutën dhe me aktet ndërkombëtare, të cilat janë pjesë përbërëse e Kushtetutës, në përputhje me nenin 53 të Kushtetutës, rrjedh nga kompetenca kryesore e Gjykatës. Për të qenë një kërkesë në përputhje *ratione materiae* me Kushtetutën, e drejta në të cilën thirret parashtruesi i kërkesës duhet të jetë e mbrojtur me Kushtetutë.
19. Parashtruesi thekson në një shkelje të dyshuar në lidhje me interpretimin e "Statutit të Lëvizjes Vetëvendosje". Lëvizja Vetëvendosje nuk është një autoritet publik. Prandaj, kërkesa është e papajtueshme *ratione materiae* me Kushtetutën, sepse kompetenca e Gjykatës Kushtetuese e cila mbulon mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me shkeljen e supozuar të Kushtetutës nga ana e autoriteteve publike. Prandaj, kërkesa është e papajtueshme *ratione materiae* me dispozitat e Kushtetutës dhe, si e tillë, është e papranueshme

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 48 të Ligjit; dhe në pajtim me rregullin 36.3.f të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 25 janar 2013, njëzëri

## VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

  
Arta Rama-Hajrizi



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

  
Prof. dr. Enver Hasani